



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 11-19
31.01.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24, dhe në lidhje me nenin 143 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-330/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-365/6 datë 30.01.2025, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 3-të, mbajtur më 29.01.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim
për paralajmërim publik

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, që sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryen veprimtari në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçisht, Bogovinë dhe Kërçovë, për shkak se në territorin e komunës së Kërçovës ka ritransmetuar shërbimin programor-Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevail SHPKNJP Tetovë (TV KOHA), që nga Agjencia ka marrë leje për transmetimit në nivel rajonal për rajonin D-8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçishtë, Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelinë), që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-330/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimeve elektronike, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, komunikacion dhe shërbime MULTIMEDIA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, menjëherë pas marrjes së këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me nenin 143 paragrafi (1) të LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor - TV KOHA në territorin e komunës së Kërçovës.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe ka harmonizuar ritransmetimin e shërbimit programor në pajtim me nenin 143 paragrafi (1) të LSHMAAV.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij aktvendimi nuk vepron sipas aktvendimit, respektivisht vazhdon kryejën e shkeljes për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe datë e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia, në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të Rregulloreve miratuar në bazë të tij dhe kushteve dhe detyrimeve të lejeve.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia me datë 21.01.2025, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 143 paragrafi (1) të LSHMAAV, sipas të cilit operatori mund të ritransmeton shërbime programore të transmetuesve vendas vetëm në zonën e shërbimit për të cilën i është dhënë leja për të ofruar transmetim televiziv ose radio dhe në bazë të së drejtës së rregulluar autoriale dhe të drejtave të përafërta, në përputhje me rregulloret për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, ndërsa në raste të ritransmetimit të shërbimit programor të transmetuesve vendas që i ritransmeton përmes kapaciteti transmetues të multipleksi digjital tokësor dhe në bazë të marrëveshjes lidhur në pajtim me nenin 141-a të LSHMAAV.

Gjatë mbikëqyrjes, Agjencia konstatoi se operatori Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, komunikacion dhe shërbime MULTIMEDIA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, e cila sipas njoftimit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtarin në territorin e komunës së Gostivarit, Vrapçishtes, Bogovinës dhe Kërçovës, në territorin e komunës së Kërçovës ka ritransmetuar shërbim programor – Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV KOHA Mevail SHPKNJP Tetovë që nga Agjencia ka marrë leje për transmetim në nivel rajonal për rajonin D-8 – Kodra e Diellit (Tetovë, Gostivar, Vrapçishtë, Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Jegunovcë, Zhelino), që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (1) të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar detajisht në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-330/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, si dhe në lidhje me nenin 143 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-330/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. _____ datë ____ . ____ .2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim ku ndaj subjektit në fjalë të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me nenin 143 paragrafi (1) të LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë me ritransmetim të shërbimit programor – TV KOHA në territorin e komunës së Kërçovës.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, respektivisht sipas paralajmërimit publik, dhe ka harmonizuar ritransmetimin e shërbimit programor në pajtim me nenin 143 paragrafi (1) të SHMAAV.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrejtetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.11-330/1 datë 23.01.2025 .

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrejtetit publik të komunikimeve elektronike ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.